

 **BITEK** Sh.p.k.

Nr. [REDACTED] Data 15.01.2012
VRAGOLI - KOSOVË



BITEK®
GERMAN TECHNOLOGY

bazuar në nenin 23.4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës në Kosovë, sot, më datë 15.01.2012 u
lidh kjo

MARRËVESHJE

Nga dhe në mes:

Ndërmarrjes "BITEK SHPK"

NRB: 70319689

Adresa: Vragoli, Fushë Kosovë

Përfaqësuar nga **Shefik NEZIRI** në cilësinë e Drejtorit

DHE:

Emri dhe mbiemri: [REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]


DUKE PATUR PARASYSH SE:

- i. Punëdhënësi dhe Punëmarrësi kanë lidhur kontratë mbi punën (tani e tutje referuar si Kontrata) më datë **15.01.2012** me të cilën është themeluar marrëdhënia e punës me punëmarrësin;
- ii. Me kontratë i kanë përcaktuar kushtet dhe kriteret e kontratës konform dispozitave ligjore;
- iii. Më kontratë janë precizuar orët e punës prej gjithsejt 40 orë në javë;
- iv. Punëmarrësi është dakorduar me vullnet të plotë që të punojë edhe orë shtesë në mënyrë vullnetare;

Andaj, Palët kanë arritur Marrëveshjen si në vijim:

1. Punëmarrësi me këtë Marrëveshje ka shprehur vullnetin që përvec orëve të punës të përcaktuara me kontratën e punës prej gjithsejt 40 orë në javë dhe orarit ditor prej 08:00 deri në 16:00 të punojë edhe nga 2 orë shtesë në ditë, që nënkupton orarin ditor prej 08:00 deri 18:00, pra 2 ore ne ditë, si dhe cdo të shtunën prej 08:00 deri 18:00 orë.
2. Punëmarrësi dhe Punëdhënësi janë pajtuar që orët shtesë të precizuara në pikën 1, të kompensohen me pagesë shtesë, ashtu që për orët shtesë prej të hënës deri të premten do të paguhen prej 30 % orën kurse për orët shtesë në fundjavë, respektivisht të shtunën, do të paguhen 50 % orën.
3. Kjo Marrëveshje është pjesë përbërëse e Kontratës mbi Punën të lidhur në mes Punëmarrësit dhe Punëdhënësit dhe do të mbes në fuqi derisa të shfuqizohet nga palët kontraktuese.
4. Me këtë Marrëveshje rregullohet vetëm çështja e orëve shtesë jashtë orarit të plotë të punës që tejkalojnë 40 orë në javë dhe se në asnjë mënyrë nuk ka ndikim në dispozitat tjera të kontratës së punës.
5. Punëmarrësi pohon, konfirmon dhe garanton se në këtë Marrëveshje hyn me vullnet të plotë, me pëlqim të tij, pa kurrëfarë presioni nga Punëdhënësi dhe se para nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje e ka lexuar dhe e ka kuptuar përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje duke qenë në tërësi i vetdijshëm se duke hyrë në këtë Marrëveshje, nuk është duke shkelur asnjë dispozitë ligjore.
6. Palët konstatojnë se neni 23.4 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës në Kosovë përbën bazën ligjore të kësaj Marrëveshjeje.
7. Kjo Marrëveshje nuk rregullon çështjen e punës jashtë orarit në rastë të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme të paraparë me nenin 23.1 të Ligjit të Punës, sipas të cilës dispozitë punëtori sipas kërkesës së punëdhënësit duhet të punojë me gjatë se orari i punës, më së shumti deri në tetë (8) orë në javë. Kjo çështje është e rregulluar me Kontratën mbi Punën.
8. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Palët kontraktuese.

Punëmarrësi



Punëdhënësi:

Shefik NEZIRI
Shefik NEZIRI

Drejtor